

Prospekt për kërkimin e morrave

Prindër të nderuar

Në klasën/foshnjoren e fëmijës suaj te një fëmijë janë gjetur thërija (vezë morrash) ose morra.

Nuk ka arsye të merakoseni! Thërijat apo morrat nuk janë shenjë e mungesës së kujdesit ndaj trupit, morrat paraqiten edhe te kokat e përkujdesura mirë. Andaj: le t'i gjuajmë morrat e jo fajtorët.

Bashkëpunëtorja jonë për intervenim me rastin e infektimit nga morrat e kokës sot i ka kontrolluar shkurt flokët e tërë klasës dhe ka konstatuar me sa vijon:

- ☐ S'ka morra, s'ka thërija → s'ka nevojë për masa të mëtejme
- ☐ Thërija, por jo morra → kërkoni morrat, shikoni më poshtë
- ☐ morra të gjallë → nevojitet trajtim (shiko faqen e dytë) dhe sërish e sërish të krihen flokët sipas mënyrës së kërkimit të morrave

Kërkimi i morrave:

Krehja/kërkimi i morrave kërkon kohë (30-60 minuta), dritë të mjaftueshme dhe një angazhim/argëtim të mirë të fëmijës, në mënyrë që ai të rrijë ulur i qetë.

Krehja e lagët: Kjo metodë për trajtim realizohet dy herë në javë dhe për mbrojtje një herë në javë si më poshtë:

- I lagni flokët
- Kremin e pastrimit (Conditioner) e shpërndani në tërë flokët. Ai i paralizon për një kohë morrat dhe e lehtëson krehjen. Flokët i shpupuritni me një krehër normal e pastaj kaloni te përdorimi i krehrit të morrave.
- Me krehër morrash i kreh mirë flokët tufë për tufe nga lëkura e kokës (aty ndodhen më së shumti morra/thërija) e deri te majat e flokëve, kurse shkumën e kremit e shtrijmë në një letër të bardhë. Në këtë mënyrë shihen më mirë morrat dhe larvat (të vegjlit e morrave). Përveç kësaj, ka mundësi që me këtë të jenë krehur edhe vezët/thërijat. Me këtë rast, vezët do të jenë të dukshme si pika të errëta në letër. Thërijat e bardha ndërkaq vështirë se mund të shihen.

Në qoftë se janë gjetur vetëm thërija, atëherë duhet që kërkimin e morrave ta bëni edhe dy herë të tjera në distancë prej tre ditësh. Në qoftë se më pastaj nuk gjeni më morra, kjo do të thotë se kjo temë është mbyllur (problemi është zgjidhur)! Nuk ka nevojë më edhe për ndonjë masë tjetër shtesë.

Testi vlen si pozitiv (d.m.th. kemi një infektim nga morrat e kokës), atëherë kur është gjetur një morr ose një larvë. Zbulimi i vezëve/thërijave akoma nuk do të thotë se kemi të bëjmë me infektim morrash, pasi thërijat janë të parrezikshme, ato mund të ndodhen aty nga një infektim i mëhershëm i morrave. Thërijat vështirë se duken, nëse janë të gjalla ose të ngordhura.

Mjeku i shkollës

GemeinschaftsPRAXIS
Dr. Kamelija Gropp
Dr. Thomas Gropp
Oberer Garten 1, 8598 Bottighofen
071 688 44 75

E autorizuar për intervenim në rast infektimi nga morrat e kokës

Helga Keller
helga.keller@gmx.ch

Stellvertretung:
Frau Schläfli 079 302 71 59 / 071 672 43 41

Prospekt për trajtimin e morrave

Në rast të infektimit nga morrat preferohen këto mjete kundër morrave:

Prioderm	e merr përsipër sigurimi shëndetësor
Loxazol	shumë sigurime shëndetësore e marrin përsipër
Laus-Stopp von Rausch	me substanca natyrore

Këto ju i merrni në ndonjë apotekë ose te mjeku i shtëpisë/i fëmijëve. Ju lutemi përdoreni këtë sipas udhëzimeve të bashkëngjitura në paketë. Përveç kësaj, ju duhet që deri në fund të trajtimit dy herë në javë ta bëni kërkimin e morrave në flokë.

Masat e domosdoshme shtesë:

- Me rastin e mënjanimin të zbulimit të flokëve pa dashje mund të merren e të barten edhe morra. Prandaj, krehrit, brushat, kapëset e flokëve (tokat), gomën e flokëve etj. i lini për nga 10 minuta në një sapun të lëngët në temperaturë të nxehtë prej 60°C.
- Flokët e gjata brenda ditës i lidhni bashkë, në mënyrë që të mos preken dhe që morrat të mos mund të zvarriten nga koka në kokë.
- Një kontroll javor i të gjithë anëtarëve të familjes me një krehje të lagët (shiko më lart) deri në dy javë pas gjetjes së fundit të larvave ose morrave.

Masa të tepërta, të panevojshme:

- Larja e çarçafëve, pizhameve, rrobave, peshqirëve të banjës dhe të dorës
- Pastrimi i dysheve, i kanapeve ose i shtretërve me fshesë me korrent
- Morrat nuk mund të barten përmes mbulesës së kokës. Kësulatat, helmetat etj. nuk duhet të trajtohen.
- Kafshët prej stofi nuk duhen izoluar nga fëmijët, nuk duhen larë dhe nuk duhen vendosur në frigorifer.
- Flokët nuk duhen shkurtuar, sepse mjaftojnë pesë milimetër gjatësi floku që të zënë vezët/thërijat.

Bashkë me këtë prospekt fëmijës suaj i jepet edhe një krehër thërijash nga ana e shkollës. Për trajtimin e mëtejshëm jeni përgjegjës vetë ju si prindër.

Informata të mëtejme: www.lausinfo.ch

Mjeku i shkollës

GemeinschaftsPRAXIS
Dr. Kamelija Gropp
Dr. Thomas Gropp
Oberer Garten 1, 8598 Bottighofen
071 688 44 75

E autorizuar për intervenim në rast infektimi nga morrat e kokës

Helga Keller
helga.keller@gmx.ch

Stellvertretung:
Frau Schläfli 079 302 71 59 / 071 672 43 41